



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.136/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Nenad Lazic dhe Afijete Sada Glllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterëve të kandidatëve të tyre në afërsi të objekteve publike apo private, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 02.10.2019, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.136/2019 e datës 30.09.2019, e paraqitur nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Më datë 30.09.2019, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se më datë 30.09.2019, rreth orës 14:00, nga ana e zyrës ligjore të PDK-së, qendra në Prishtinë, në shesh, tek ndërtesa mbi ProCredit Bank, janë vërejtur posterë të vendosur në ndërtesë publike apo private, e të cilët posterë i takojnë njërit prej kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, Me këtë paraqitësi i ankesës ka pretenduar se ky veprim i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, respektivisht nenin 33 pika b) të këtij ligji, poashtu ka shtuar se ky veprim paraqet shkelje të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013 – “Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike”.

Paraqitësi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur fotografi të posterëve të kandidatit për deputetë nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje.

Në përgjigjen në ankesë të datës 30.09.2019, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), thekson se pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën Anr.136/2019, të datës 30.09.2019, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), janë të pabazuara për faktin se billbordi i kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, Albin Gashi, është vendosur në pronë private, respektivisht në pronën e babait të kandidatit në fjalë,

Tomë Gashi, dhe atë në murin e jashtëm të banesës së shndërruar në zyrë nga ana e tij duke shtuar se për vendosjen e këtij billboardi është dhënë pëlqimi nga vetë avokati Tomë Gashi. Paraqitësi i përgjigjes në ankesë si dëshmi për pretendimet e tij, ka bashkangjitur në përgjigje pëlqimin për vendosjen e billboardit në pronën e tij nga avokati Tomë Gashi si dhe kontratën mbi shitblerjen e banesës me të cilën vëretohet se prona në fjalë i takon avokatit Tomë Gashi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar,

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, nuk është bërë shkelje e nenit 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterët lëndor të kandidatit për deputet nga radhët e këtij subjekti politik, janë vendosur në pronë private, me pëlqimin e dhënë nga pronari.

Paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet e paraqitësit të ankesës se këto veprime përbëjnë shkelje të dispozitës së nenit 33, pika b), të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, pasi që posterët në fjalë janë të vendosur në pronë private, me pëlqimin e pronarit, gjë kjo e cila vërtetohet nga provat e bashkangjitura në përgjigje në ankesë nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, ndërsa sa i përket pretendimeve të paraqitësit të ankesës për shkeljen e dispozitave të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, të njëjtat u refuzuan si të pabazuara, për faktin se dispozitat të cilat paraqitësi i ankesës pretendon se janë shkelur nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, nuk e sanksionojnë vendosjen e posterëve në pronë private në rastet kur ekziston pëlqimi i pronarit për vendosjen e tyre.

Nga arsyet e theksuara më lartë, e duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.136/2019 më datë 02.10.2019

Kryesues i Panelit

Faton Ademi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.

